

UDHËZIM
Nr.2, datë 5.11.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 20.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË
BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2008”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.1, datë 20.8.2008, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në tabelën nr.1 “Kostoja mesatare e ndërtimit, për vitin 2008”, në kolonën “Çmimi për njësi sipërfaqeje shfrytëzimi” në renditjen 18 “Bashkia Burrel”, shifra 35 539 lekë/m² të bëhet 33 539 (tridhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë/m².
 - b) Në tabelën nr.2 “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve sipas qyteteve, për vitin 2008”, në kolonën “Qytetet”, renditja 2, fjala “Vlora” bëhet “Vora”.
 2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha